

Informata për prindërit, në mënyrë që të zgjedhin një vend- pritje apo shërbim në shtëpi me cilësi për fëmijët e tyre.

Shpesh është e vështirë për prindërit se kujt t'ia besojnë fëmijën. Kabinetet e pediatriëve apo të tjera vende ku konsultohen prindërit (kurset për nënat, përgatitja për lindjen, maternitetet, mamitë, konsultat për foshnjët, Shkolla për prindërit, Pro Juventute...) janë vende informacionesh dhe këshillash për shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës, duke përfshirë edhe çështjet e mbajtjes së fëmijës.

Duke ju referuar modelit të zhvilluar nga Akademia Amerikane e Pediatriisë, ne propozojmë një informacion për prindërit si dhe disa kritere për t'i ndihmuar në zgjedhjen e tyre.

Ky dokument do të shpërndahet në konsultoret e ndryshme që frekuentohen nga prindërit dhe mund të konsultohet gjithashtu në një faqe interneti (në frëngjisht) :
www.swiss-paediatrics.org

Për komitetin e Shoqates Zvicerane të Pediatriisë - SSP

Doktoreshë Nicole PELLAUD

Janar 2004

Kujt t'ia besoni fëmijën tuaj

Ju uroni gjithçka që është më e mirë për fëmijën tuaj. Por ndonjëherë është e vështirë se kujt t'ia besoni. Ja disa nga udhëzimet përgatitur për ju nga Shoqata Zvicerane e Pediatriisë, bazuar në ato të Akademisë Amerikane të Pediatriisë, (shëndeti i fëmijës :Cka është më e mirë për fëmijën tuaj - AAP 2000)

Kujt t'ia besoni fëmijën tuaj :

Mundësi : - T'jua mbajnë fëmijën në shtëpi *fishë nr.1*

- në familje pritëse, *fishë nr.1*

- Çerdhe familiare , *fishë nr.1*

- Mbajtja e fëmijëve të sëmurë si dhe ndihmë e herëpashershme në rast nevoje,

Si të zgjidhni : - personin në shtëpi *fishë nr.2*

- një familje pritëse *fishë nr.3*

- një çerdhe familiare *fishë nr.3 dhe 4*

Si ta përgatisni fëmijën tuaj : *fishë nr.5*

Kujt t'i drejtoheni : *fishë nr.6*

Mundësitë :

Personat që kujdesen për fëmijën tuaj mund të jenë të familjes tuaj, miq, jo profesionistë apo profesionistë të fëmijës së vogël.

Ju mund të zgjidhni mes tre mundësive :

- * kujdesje në shtëpi,
- * familje pritëse,
- * institucione të fëmijës së vogël,

Merrini masat shumë kohë më përpara (disa muaj). Duhet ta dini që një urdhëresë federale rendon mbikqyrjen e pritjeve jashtë familjare (familje pritëse, institucionet e fëmijës së vogël) dhe zbatimin e saj u është lënë në dorë vetë kantoneve.

Kujdesja në shtëpi mund të jetë shumë praktike. Personat që mbajnë fëmijët në shtëpi mund të përshtaten sipas nevojës tuaj, fëmija juaj nuk ka nevojë t'i përshtatet një ambienti të ri, ai do të përfitojë nga një përkushtim vetjak sidomos kur personi nuk ka punë të tjera shtëpiake.

Fakti që fëmija qëndron në shtëpi ul ekspozimin ndaj infeksioneve stinore që janë të larta në jetën kolektive në institucion për shembull.

Shpesh është e vështirë të gjenden persona kompetente. Duhet parashikuar një zgjidhje kur personi është i sëmurë apo në pushime. Ju vetë jeni gjykuesi i personalitetit, i shëndetit dhe i kompetencave të personit që ruan fëmijën tuaj. Ju nuk keni kontroll në aktivitetin e saj në mungesën tuaj. Ju nuk mund të shpresoni që një vajzë e re (babysitter) t'i përmbushë kushtet e mësipërme, kjo është vetëm për të dhënë një ndihmë në disa raste të veçanta.

Si ta zgjidhni një person për mbajtjen e fëmijës ? : shih fishën r.2

Familja pritëse e pret fëmijën tuaj tek ajo, shpesh ajo ka edhe fëmijët e vet në shtëpi. Familja pritëse mund të mbajë fëmijë të të njëjtës moshë apo të moshave të ndryshme.

Shërbimi kantonal kompetent është baza që siguron vlerësimin dhe formimin e familjes pritëse.

Si ta zgjidhni një familje pritëse ? : shih fishë nr.3

Institucionet e fëmijës së vogël paraqiten me emra të ndryshëm : Hapësira e jetës së fëmijës, çerdhe e kopshte fëmijësh, duke përfshirë ato jopublike apo të subvencionuara.

Të gjitha këto vende duhet të kenë lejen dhe kontrollin nga shërbimi kompetent kantonal, çka ju ofron një garanci të cilësisë së pritjes. Oraret janë të ndryshme, në përgjithësi ato të çerdhes dhe hapësirës së jetës së fëmijës korrespondojnë pak a shumë me orarin e punës së prindërve, përndryshe ato të kopshtit dhe të çerdhes janë më të kufizuara. Cerdhet dhe hapësirat e jetës së fëmijës presin në mënyrë të rregullt fëmijë nga 0 në 4 vjeç, për kopshtin (garderie apo kindergarten) mosha e pranimit varion, disa nga këto institucione presin fëmijë qysh prej 15-18 muajsh. Pritjet apo kujdesja e përkoshme (halte-garderies) ofrojnë një pritje, sipas rastit dhe nevojës, të kufizuar në kohë dhe duke filluar nga mosha 18 muajsh.

Fëmija juaj do të pritet në kolektivin e fëmijëve sipas normave në fuqi, vendosur prej profesionistëve të fëmijës së vogël, ai do të ketë një edukator apo edukatore përgjegjëse dhe do të marrë pjesë në programin e institucionit. Kjo lloj formule nuk rekomandohet për një pjesë të fëmijëve mbartës sëmundjesh që ulin imunitetin e tyre ndaj sëmundjeve infektive, ndërsa për fëmijë të tjerë masat parandaluese (higjiena dhe vaksinimet) bëjnë të mundur uljen e rrezikut të këtyre sëmundjeve. Disa fëmijë që kanë nevojë për masa të veçanta për shëndetin dhe zhvillimin e tyre, në marrëveshje me drejtuesit e institucionit, mund të pritet në institucion me lejen e mjekut-pediatër dhe marrjen e masave në bashkëpunim me ekipin mediko-social. Në qoftë se fëmija juaj paraqet një problem shëndeti që nevojitet marrjen e masave të veçanta, kontaktoni me mjekun-pediatër.

Në disa kantone, infermierët dhe qendra mediko-sociale bashkëpunojnë me ekipet edukative përsa i përket çështjes së shëndetit.

Si të zgjidhni një institucion ? : shih fishën nr.4

Cerdhet familiare janë një zgjidhje e mesme midis familjes pritëse dhe institucionit. Që të dyja janë të autorizuara nga shërbimi kantonal kompetent.

Praktikisht vendqëndrimi i fëmijës është familja që e pret në mëngjes, që i jep ushqimin, e vë në gjumë etj. Ai do të kalojë disa orë në ditë në institucion me fëmijë të tjerë, në aktivitete të drejtuara nga profesionistë të fëmijës së vogël dhe nga "nënat" që i ruajnë në shtëpi, të cilët bashkëpunojnë me institucionin sipas orareve të caktuara. Ky lloj sistemi paraqet avantazhin e orareve më pak të ngurta si dhe përvojën e dyfishtë të jetës familiare dhe kolektive.

Si ta zgjidhni një familje pritëse ? : shih fishë nr.3

Si ta zgjidhni një institucion ? : shi fishë nr.4

Mbajtja e fëmijëve të sëmurë dhe ndihma e herëpashershme në rast nevojë : ky lloj shërbimi mund t'ju ofrohet nga Kryqi i Kuq i zonës suaj apo qendra mediko-sociale.

Si të zgjidhni personin që do të mbajë fëmijën në shtëpinë tuaj :

Ju vetë duhet të gjykoni personalitetin, shëndetin dhe kompetencat e personit të angazhuar.

Cfarë duhet të keni kujdes :

1. Personaliteti, ekuilibri mendor : a mundeni ju t'ia besoni fëmijën ?
2. Kënaqësia që personi shpreh për t'u kujdesur për fëmijë,
3. Lidhjet dhe kontakti me fëmijën (kënaqësi e dyanshme),
4. Aspekti: shëndeti, higjiena vetjake.

Cfarë duhet t'i kërkonti :

1. Lejen e punës, sigurimin e aksidenteve, të jetë jo i ndjekur nga gjykata, referencat, çertifikatë mjekësore,
2. eksperiencat e mëparshme, formacionet (kursin e ndihmës së shpejtë, të baby-sitting ?)
3. Perceptimi i punës me fëmijët,
4. Të jetë dakord me kërkesat tuaja (shërbimi, edukimi, sigurimi etj...),
5. Tabagizmi : zgjidhni në mënyrë absolute një person që nuk e pi duhanin,
6. Të bini dakord për rrogën, pushimet apo ditët e pushimit, etj...

Si të zgjidhni një familje pritëse

Pikat e mëposhtme janë vlerësuar pranë familjeve pritëse me pëlqimin e shërbimit kantonal kompetent.

Kriteret tuaja vetjake janë të rëndësishme, ato bëjnë të mundur që të keni sigurinë se hapësira dhe praktikat e familjes pritëse t'u përgjigjet kërkesave tuaja.

Cfarë duhet të keni kujdes :

1. Numri i fëmijëve që shkojnë në familjen pritëse (maksimum 6, por jo më shumë se 2 për fëmijët nën dy vjeç),
2. Dëshirë e kënaqësi nga personi që pret fëmijën ,
3. Atmosferë e këndshme,
4. Fëmija të jetë i gëzuar kur shkon te familja pritëse,
5. Shëndeti fizik dhe mendor i personit pritës (si dhe i fëmijëve të tij),
6. Apartamenti të jetë i mirëndriçuar, i ajrosur, i sigurt, i pastër, i mirëmbajtur, niveli i zhurmës i ulët, hapësira e mjaftueshme (4m² për fëmijë),
7. Të ketë një hapësirë të vogël me krevat apo djep, dyshek ose mbulesë individuale në mënyrë që fëmija të jetë i kontrolluar gjatë gjumit,
8. Një kënd të vogël për ndërrimin e teshave të fëmijës me një lavaman pranë,
9. Tualet e lavaman të pastër dhe lehtësisht të përdorshëm, peshqir dhe sapun të lëngshëm si dhe letër tualeti,
10. Higjiena e personit pritës : të lajë duart pasi të ketë ndërruar fëmijën, letra higjienike, tualet (për të rriturit dhe fëmijët),
11. Ushqimi i mirëpërgatitur, me shërbim të mirë, përshtatur moshës, t'i jepet fëmijës në prehër sipas peshës. Të kontrollohet mundësisht menuja,
12. Lojra të ndryshme, të sigurta dhe përshtatur moshës,
13. Mundësi për të dalë çdo ditë nga pak në hapësirë të gjelbëruar, në një kënd lojrash përshtatur moshës dhe të sigurt,

Cfarë t'i kërkoni familjes pritëse :

1. Vendi pritës, a është i miratuar nga shërbimi kantonal kompetent ?,
2. A mundeni ju t'i shihni të gjitha hapësirat dhe vendin ku fëmija juaj do të shkojë ?,
3. Cfarë aktivitete janë parashikuar brenda dhe jashtë këtij vendi pritës ?,
4. Shikimi i TV, a është parashikuar për periudha të shkurtra me programe të përshtatura për fëmijën ?,
5. A është e ndaluar rreptësisht pirja e duhanit në prani të fëmijës ?, Një person apo apartament që mban erën e duhanit nuk janë të pranueshëm për fëmijën tuaj,
6. Cfarë është parashikuar në qoftë se fëmija juaj është sëmurë (çfarë duhet bërë, kush do t'ia japë ilaçet dhe në çfarë kushtesh ?),
7. Personi i familjes pritëse a është i formuar :
 - mbi zhvillimin e fëmijës,
 - mbi ndihmën e shpejtë,
 - mbi parandalimin e aksidenteve,
 - mbi parandalimin e infeksioneve,
8. Orari : cilat janë mundësitë tuaja ?
9. Cfarë zgjidhje keni gjetur në qoftë se personi i familjes pritëse është sëmurë apo mungon ? ,
10. A mund të keni rekomandime nga prindër të tjerë të cilët i kanë dërguar më herët fëmijët e tyre tek familja pritëse në fjalë ?,
11. A keni marrë informata mbi çmimin dhe se çfarë ndodh në rast se familja pritëse mungon ?,
12. A jeni të qetë t'ia besoni fëmijën familjes pritëse ?,
13. Vendndodhja : A është praktik për ju vendi i pritjes duke patur parasysh vendbanimin dhe vendin tuaj të punës ?.

Si të zgjidhni një institucion të fëmijës së vogël :

Institucionet e fëmijës së vogël janë të gjitha nën mbikqyrjen dhe autoritetin e shërbimit kantonal kompetent.

Për të siguruar kushte të mira për shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve, ato mund të bashkëpunojnë me profesionistë të ndryshëm të mjediseve mediko-sociale.

Si prindër, ju mund të siguroheni për pritjen me cilësi të fëmijës tuaj, në sajë të këtij bashkëpunimi e vlerësimi të institucionit.

Kriteret tuaja vetjake mund të jenë të ndryshme, duhet të jeni të kujdesshem për aspektin :

- praktik (largësia, orari),
- e marrëdhënieve (duhet që ju dhe fëmija juaj të ndiheni mirë),
- e mjedisit (vendi a ju pëlqen, gjithashtu dhe fëmijës tuaj),
- pedagogjik (projekti pedagogjik ju përshtatet).

Fundi i faqes nr-8 dhe fishës nr.4

Si ta përgatitni fëmijën tuaj ? :

Shumica e fëmijëve deri në 7 muaj përshtaten më shpejt me vendin e pritjes dhe me personat që do të kujdesen për ta.

Fëmijët më të rritur reagojnë më fort dhe do të kenë nevojë për mbështetjen tuaj në mënyrë që të familjarizohen me personat pritës në institucion.

Disa nga fëmijët paraqesin ndryshime në sjellje kur i besohen tjetërkujt. Më të vegjëlit mund të qajnë, zemërohen, refuzojnë të largohen nga shtëpia për të shkuar në institucionin pritës, apo manifestojnë të tjera forma të pakënaqësisë. Fëmijët më të rritur mund të pësojnë regres, të sillen si foshnje dhe të zgjohen natën.

Kjo sjellje largohet pas disa ditësh apo javësh, në qoftë se fëmija është pritur me cilësi dhe ngrohtësi në institucionin pritës.

Ju mund t'ia ulni frikën fëmijës tuaj duke :

- vizituar vendprirjen përpara, bashkë me fëmijën,
- tregojini fëmijës që vendi ju pëlqen dhe se keni besim te personi që do ta presë.
- organizoni një vizitë te ju, kur bëhet fjalë për një person që do të ruajë fëmijën te ju, dhe kërkojini atij që të ruajë fëmijën për një periudhë të shkurtër.

Disave prej fëmijëve ju pëlqen te marrin me vehte diçka që u kujton shtëpinë (send, lojra, ndonjë rrobë të mamasë apo fotografi...)

Flitini fëmijës për vendin pritës dhe personin që do të kujdeset për të.

Përgatitja dhe familjarizimi do të lehtësojnë këtë përvojë të re.

Ekzistojnë gjithashtu libra që tregojnë dhe flasin mbi vendet pritëse, mund t'i lexoni së bashku.

Kur fëmija juaj është përshtatur me vendprirjen, një ndryshim i edukatores mund ta çrregullojë, edhe pse edukatorja e re mund të jetë e sjellshme dhe kompetente.

Në rast nevoje, diskutoni me edukatoren, është mirë të bashkëpunoni në të gjitha rastet kur fëmija juaj haset me ndryshime, qoftë në shtëpi apo në vendin pritës.

Një vend pritjeje (lieu d'accueil) me cilësi do t'i lejojë fëmijës suaj të rritet dhe zhvillohet mirë qoftë në aspektin fizik ashtu dhe në atë social e mendor.

Për të tjera informacione :

Për të gjetur adresat e institucioneve dhe familjeve pritëse, ju mund t'i drejtoheni komunës suaj ose në adresën Pro Juventute të rajonit tuaj.

Cdo kanton është përgjegjës në autorizimin dhe mbikqyrjen e vendeve pritëse, ky mandat i është dorëzuar Shërbimit kantonal kompetent për fëmijët dhe të rinjtë, emrat e të cilit ndryshojnë nga njëri kanton në tjetrin (shërbimi i mbrojtjes së të rinjve, shërbimi i ndihmës së të rinjve etj...)

Për çdo pyetje mbi shëndetin e fëmijës suaj kur ia besoni atë një vendpritjeje, drejtojuni mjekut tuaj pediatër.